

VENDIM
Nr. 25, datë 16.2.2016

**MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “HEC TERVOLI” SHPK, PËR
LËNIE SI GARANCI HIPOTEKORE PRANË RAIFFEISEN BANK, TË ASETVE QË
DISPONON**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44, 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 7 dhe 11, të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.2.2016, pasi shqyrtoi kërkesën për lënien si garanci hipotekore të aseteve të shoqërisë “HEC Tervoli” sh.p.k. pranë Raiffeisen Bank, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HEC Tervoli” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pikat 1.1 dhe 1.2 (ky informacion është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte).
- Neni 7, pika 1.3, germet “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h” (ky informacion është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte).
- Neni 7, pikat 2, 3, 4 dhe 5 (ky informacion është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte).
- Me vendimin nr. 163, datë 28.12.2015, Bordi ERE-s, ka vendosur fillimin e procedurave për lënien peng. Gjatë hetimit nga ana e ERE-s është konstatuar se subjekti ka hyrë në marrëveshje me Bankën për të lënë asetet që disponon, si garanci hipotekore.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “HEC Tervoli” sh.p.k. për lënie si garanci hipotekore pranë Raiffeisen Bank, të aseteve që disponon, si më poshtë:

- a) Gjeneratori elektrik, panele elektrike, turbina, nënstacion elektrik;
- b) Pasuri e paluajtshme, 1028 m² ndërtim, referuar certifikatës së pronësisë me nr. 224065;
- c) Central elektrik, pasuri e paluajtshme sip. 4950 m², certifikatë pasurie nr. 268960;
- d) Central elektrik, pasuri e paluajtshme 3800 m², certifikatë pasurie nr. 268962.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti